

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti,** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. Sh. nga fsh. R. K-Gjakovë, për shkak të veprës penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale si dhe neni 49 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr.258/2016 të dt.03.05.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **17.10.2016,** në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, përf. të autorizuar të dëmtuarës KPMM-ës sipas autorizimit R. M. dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D. Sh.,** i biri i Q. dhe i nënës H. e gjinisë D. i lindur me dt. ..., ne fsh. R. K. Gjakovë, ku edhe tani banon, ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, me ID....

Ë s h t ë f a j t o r :**Sepse:**

- Me dt. 16.02.2016, nga ana e inspektorëve te KPMM –ës, Sh. H. dhe N. J., është zënë duke operuar ilegalisht ne shfrytëzimin e resurseve minerare te rërës dhe zhavorrit, ne fsh. R. K-Gjakovë, pa u pajisur me licencë te veçantë ne koordinatat Y=7466268; 7466274; 7466255, X=4688018; 4688031; 688021, Z=321;321,320, për te cilat koordinata nuk posedonte licencë për shfrytëzimin e mineraleve te rërës dhe zhavorrit te lëshuar nga organi kompetent i KPMM-ës, me çka te dëmtuarës i ka shkaktuar dem material ne vlere prej 1.339,51euro .

- **me çka ka kryer vepër penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale si dhe neni 49 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale.**

Andaj Gjykata në mbështetje te neni 4,41,49,50,51,73 te KPRK-ës dhe neni 80 i Ligjit për Miniera dhe Minerale si dhe neni 49 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale, te akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Me dënim me burgim me kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **30,00 €**, e këtë në afat prej **15 ditësh,** pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.258/16 të dt. 03.05.2016, e ka akuzuar të akuzuarin D. Sh. nga fsh. R. K- Gjakovë, për shkak të veprës penale nga neni 80 i Ligjit për Miniera dhe

Minerale si dhe nenit 49 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.17.10.2016, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurori Ramiz Buzhala, lexojë aktakuzën PP.nr. 258/16 të dt. 03.05.2016 dhe deklaroi mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari D. Sh. gjatë shqyrtimit fillestar, deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimin të fajësisë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtojë se unë isha duke punuar si punëtor (argat) andaj i propozoj gjykatës duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike si dhe faktin se asnjëherë me parë nuk kam qene i dënuar nga ana e gjykatës, të me shqiptojë një dënim sa më të butë.

Përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D. Sh. me dt. 16.02.2016, nga ana e inspektorëve të KPMM –ës, Sh. H. dhe N. J., është zënë duke operuar ilegalisht në shfrytëzimin e resurseve minerare të rërës dhe zhavorrit, në fsh. R. K- Gjakovë, pa u pajisur me licencë të veçantë në koordinatat Y=7466268; 7466274; 7466255, X=4688018; 4688031; 688021, Z=321;321,320, për të cilat koordinata nuk posedonte licencë për shfrytëzimin e mineraleve të rërës dhe zhavorrit të lëshuar nga organi kompetent i KPMM-ës, me çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 1.339,51euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, si dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me burgim në kohëzgjatja prej 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, me shprehje dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nenit 41 të KPK-se dhe se do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me Ligj që ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPP

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.248/16 më datë 17.10.2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.